



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA III

Sesioni IV

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 07.**

Prishtinë, më 22.06.2011 në ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Agim Kuleta, Jasmina Živković, Jelena Bontić, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Etem Arifi.

Mungoi: Petar Miletić

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues nga ZKM, Lulzim Aliaj, përfaqësues të OSB-ja Elita Vokshi, përfaqësuesit nga KDI Natyra Kasumaj, përfaqësuesi nga Presidenca Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, zëvendëskryetare e parë të Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve së kaluara.
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko- Social, me raportin e Komisionit funksionale për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente.
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete , me raportin e Komisionit funksionale për Arsim, Kulturë, Rini, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media , me amendamente.
5. Shqyrtimi i propozim amendamenteve të grupit punues të Komisionit për Projektligjin nr.04/L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
6. Shqyrtimi i detyrave të Komisionit të përcaktuara lidhur me Planin e Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për tremujorin e dytë për vitin 2011.
7. Të ndryshme

Myzejene Selmani - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me plotësim të pikës: Shqyrtimi i raportit me amendamente të Projektligjit nr. 04/ L- 018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ndaj palëve të treta.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluar.

Kryesuesja – konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të datës 7.06.2011 dhe datës 10.06.2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko- Social, me raportin e Komisionit funksionale për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente.

Kryesuesja, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin . 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko- Social të propozuara nga Komisioni Funkcional. Kërkoj nga anëtarët të deklarohen nëse ka ndonjë vërejtje në amendamente në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, që do t'i dërgohen Komisionit Funkcional.

Meqë nuk kishte vërejte, kryesuesja konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin . 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko- Social, ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete , me raportin e Komisionit funksionale për Arsim, Kulturë, Rini, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media , me amendamente.

Kryesuesja, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin për Bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoj që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejte, kryesuesja konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete, ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ndaj palëve të treta, me raportin e Komisionit funksionale për Buxhet dhe Financa , me amendamente.

Kryesuesja, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ndaj palëve të treta, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoj që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejte, kryesuesja konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ndaj palëve të treta, ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i propozim amendamenteve të grupit punues të Komisionit për Projektligjin nr.04/L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,

Kryesuesja- theksoi se nënkomisioni si detyrë të saj ka punuar në përpilimin e amendamenteve në Projektligjin nr.04/L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Si rrjedhe e punës së grupi punues, janë hartuar tri Propozim –amendamentete

Kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse ka ndonjë vërejtje në amendamente të propozuara dhe se të njëjtat të përkrahen dhe t'i dërgohen për shqyrtim Komisioneve Funksionale.

Amendamenti 1

Të behët harmonizimi i teksteve, versioni në gjuhën serbishte dhe anglishte me tekstin në gjuhën shqipe.

Amendamenti 2

Neni 1. të fshihet

Amendamenti 3

Neni 3

Paragrafi 12.6 në fjalinë e parë pas emërimit Këshilli konsultativ për komunitete shtohen fjalët : „duhet të jenë,, ndërsa në fjalinë e dytë të njëjtit paragraf fjalët „**mund të jenë,,** zëvendësohet me fjalën „ **duhet të jenë,,**

Komisioni miratoi amandamentin 2 dhe 3, ndërsa kishte vërejtje në amandamentin 3, nenin 3, paragrafi 12,6: ku diskutuan Albert Kinolli dhe Mufera Sinik

Albert Kinolli- tha se grupi punues me përpikëri ka shqyrtuar Projektligjin nr.04/L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Thekso se gjatë punës jemi akorduar dhe njëherit janë hartuar tri propozim amendamente.

Ai ka propozuar që në Nenin 3, i paragrafit 12,6. ku në emërtimin e tekstit ‘Këshilli Konsultativ për Komunitete’, fjala ‘mund të jenë’ të zëvendësohet me fjalën ‘duhet të jenë’.

Myfera Sinik- u ndërlidh me parafolesin se në grup punues ka propozuar dhe njëherit është pajtuar që fjala ‘mund të jenë’ të zëvendësohet me fjalën ‘duhet të jenë’.

Lulzim Aliaj -koordinator i ZKM,. sugjeroi që në nenin 3 , pas paragrafit 12,6 të shtohet një paragraf i ri, me tekstin si vijon:

Obligimi nga paragrafi 12,6 nuk vlen për përfaqësues të komuniteteve të cilët nuk janë deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Meqë kishte vërejtje lidhur me propozimin e Lulzim Aliaj, komisioni të njëjtin nuk e miratoi.

Pas diskutimeve të shumta, kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Amendamenti 3

Neni 3

Në tekstin e paragrafit 12.6 fjala „mund të jenë„ zëvendësohet me fjalën „ **duhet të jenë**„

Kryesuesja- konstatoi se Komisioni, raportin me amandamente për Projektligjin për ndryshimin dhe plotsimin e Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës do ta procedon në Komisionet e përhershme për vlerësim.

7. Shqyrtimi i detyrave të Komisionit të përcaktuara lidhur me Planin e Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për tremujorin e dytë për vitin 2011.

Kryesuesja- lidhur me këtë pikë u përqendrua në detyrat dhe obligimet e Komisionit në plotësimin e obligimeve për tremujorin e dytë të Planit të Veprimit për Integritet Evropian të vitit 2011. Veçantë ceku se në pikën P1 të Planit të Veprimit, si detyrë kryesore do të jetë mbikëqyrja e ligjeve..

Pas konsultimeve, Komisioni vendosi se me qëllim të informimit dhe vrojtimit në shkallë të gradimit të implementimit të Projektligjit nr.04/L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, do të organizojë dhe do të ftojë në një takim Ministrin e Vetëqeverisjes Lokale, për të raportuar Komisionin.

Në bazë të analizave dhe të dhënave, Komisioni do të përpilon një raport me rekomandim për Kuvend, në funksionalizimin për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve.

8. Të ndryshme

Komisioni nuk ka pas propozime lidhur me pikën në të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zëvendëskryetar i parë i Komisionit

Myzejene Selmani